

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit SH.C. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës të mbrojtësit të akuzuarit SH.C., av. M.SH., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1480/16 datë 08.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur datë 18.03.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit SH.C., av. M.SH., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1480/16 datë 08.11.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin P.nr.1480/16 datë 08.11.2018, të akuzuarin SH.C., e ka shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të cilën e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 350 (treqind e pesëdhjetë) €, të cilin shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, në të kundërtën i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € të gjobës, do t'i llogaritet në një ditë burgim, përkatësisht 17 (shtatëmbëdhjetë) ditë burgim. I akuzuari është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë, në emër të ekspertizës mjeko ligjor në shumën prej 50 €, në emër të ekspertizës së komunikacionit në shumën prej 56.21 €, në emër të super ekspertizës në shumën prej 450 €, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 50 € dhe për kompensimin e viktimave të krimit në prej 30 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbaramit të dhunshëm. Të dëmtuarit M.TH. nga fshati ..., komuna e Prizrenit, F.M. dhe SH.M. që të dy nga Peja, rr "...", nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit SH.C., av. M.SH., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që

Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën ta aprovoj si te bazuar dhe lëndën ta kthej në rivendosje të serishme.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.190/2019 të datës 21.02.2019, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit i të akuzuarit të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i ankimuar te vërtetohet

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit me ankesë pretendon se në rastin konkret kemi shkelje të dispozitave procedurale të cilat kanë filluar që nga veprimet e policisë, ku me rastin e daljes në vendin e ngjarjes, organet policore nuk i kanë përfillur rregullat procedurale në vendin e ngjarjes, ku te ky aksident kemi tre persona të aksidentuar, që do të thotë se tre automjete janë përfshirë në aksident dhe se policia nuk ka bërë shenjëzimin e pikës goditëse dhe nuk ka foto që dëshmojnë se ku ka qenë pika goditëse.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e lartë cekura nuk janë të bazuara, aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara me ankesë, ngase në aktgjykimin e ankimuar janë të përfshira të gjitha elementet e nevojshme të aktgjykimin sikurse që parashihen me dispozitën e lartcekur, e as që ka shkelje tjera të cilat kjo gjykatë konform nenit 394 të KPP-së, çdo herë i vëren sipas detyrës zyrtare, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë, konkret dhe i kuptueshëm, në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të duhura të mjaftueshme mbi të gjitha faktet vendimtare si dhe janë paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimin. Gjykata e shkallës së parë provat e propozuara nga palët i ka i ka vlerësuar në pajtim me dispozitën e nenit 8 dhe 361 të KPP-së, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par. 7 të KPP-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të paprovuara. Ajo ka dhënë arsye në të cilat është bazuara me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimin për këtë.

Përkritazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesën e paraqitur nga ana e mbrojtësit të akuzuarit pretendohet se, në aksident ishin tri automjete dhe se nuk është vërtetuar as pika e dytë goditëse, sepse te aksidentet me tri automjete duhet të jenë dy pika goditëse ku do të pasqyronin saktë hetimin e rastit, se fotot zyrtare të bëra nga ana e policisë janë të pa qarta, të padukshme dhe se asnjë ekspert nuk mund të bie asnjë përfundim në bazë të këtyre fotove, gjë që është konstatuar edhe nga ana e ekspertëve. Sipas pretendimit të mbrojtësit të akuzuarit, në rastin kur në aksident kemi persona të lënduar policia është e obliguar të bëjë matjen e përqindjes së alkoolit, gjë e cila nuk ka ndodhur, policia nuk ka fotografuar gjurmët e

frenimit, gjurmët bartëse si dhe dëshmitë e mbetjeve në aksident, e as nuk ka fotografuar pikën orientuese dhe si pasojë e lëshimeve të bëra nga ana e organeve policore të trafikut lidhur me këtë aksident nuk mund të ketë një ekspertizë të duhur dhe reale pasi që nuk ka dëshmi, përveç disa fotove që janë të padukshme dhe që nga këto foto nuk mund të konstatohet e as të nxjerrët ndonjë përfundim profesional. Mbrojtësi i të akuzuarit konsideron se si pasojë e lëshimeve, policia është treguar e njëanshme, duke përpiluar raportin policor, duke paraqitur në mënyrë të kundërt ngjarjen, ku dhe në bazë të këtij raporti të mbrojturit tij, i cili ishte lënduar rëndë, i është ngritur aktakuza dhe sot kemi një vendim dënues, se gjatë procedurës së provave gjykatës së shkallës së parë i kanë paraqitur ekspertizën nga ana e ekspertit të komunikacionit, ku i njëjti, ka ardhur në përfundim, se deri të aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të automjetit të markës “Mercedes”, ku ky automjet për shkak shpejtësisë së madhe ka kaluar në anën e kundërt të lëvizjes dhe e ka goditur automjetin “Audi”, i cili në at moment ishte duke lëvizur në drejtim të rrugës Landovicë- Prizren, ku pika goditëse ishte diku në brendësi të shiritit të lëvizjes së automjetit të markës “Audi”, ku nga forca goditëse në mënyrë të pakontrolluar pastaj në shiritin e kundërt ndeshet me automjetin e markës “Citroen”. Mbrojtësi i të akuzuarit kërkon që të analizohet me vëmendje ekspertiza e ekspertit S.F. nga Prizreni, ku sipas tij i njëjti ekspert në mënyrë kronologjike dhe logjike ka sqaruar se si ka ardhur deri të ky aksident.

Gjykata e Apelit sipas shkresave të çështjes vlerëson se edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikurse që pa të drejtë pretendohet në ankesën e ushtruar. Se i akuzuari, ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në pa mëdyshje është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë se i akuzuari me datë, kohë dhe vend sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar ka kryer veprën penale e cila i është vënë në barrë me anë të aktakuzës. Ky fakt është vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve Fatmir Morina dhe M.TH., si dhe provat materiale si; ekspertizën mjeko ligjore datë 21.11.2015, ekspertizën e ekspertit të komunikacionit inxh. P.SH. 30.07.2015 dhe deklaratën e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 04.04.2018, super ekspertizën e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë datë 10.09.2018, raportin e oficerit datë 30.07.2015, skicën e vendit të ngjarjes dhe foto dokumentacionin si ka vlerësuar edhe mbrojtën e të akuzuarit. Nga deklaratat e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit F.M., me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar dhe ia ka falur besimin ngase i njëjti ndër të tjera ka deklaruar se natën kritike së bashku me bashkëshorten e tij ka qenë duke shkuar në drejtim të Gjakovës dhe ishte duke vozitur automjetin e tij të markës “Citroen C4”, meqë rast afër Landovicës vjen një makinë e tipit “Audi” e cila e humb drejtimin dhe del në anën e kundërt të komunikacionit dhe e godet në shiritin e tij qarkullues me pjesën e përparme të anës së majtë, ngase është munduar të kthehet në shiritin e vet të qarkullimit por nuk ka mundur dhe ka filluar të sillet vetuar e tij. Sipas dëshmitari pasi që i akuzuari ka qenë duke vozitur me drita të gjata dhe e ka penguar në vozitje nuk ka parë që i njëjti të ketë goditur ndonjë veturë tjetër, më tej ka theksuar se i vetmi person që i ka rënë në sy ishte i akuzuari ngase ka qenë i lënduar dhe i gjakosur në fytyrë. Këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar edhe nga deklaratat e të dëmtuarit M.TH. ku i njëjti ka deklaruar se, natën kritike ka ardhur në momentin deri sa ai ishte duke qarkulluar me automjetin e tij në rrugën Prizren- Gjakovë dhe kur arrin në lagjen “Arbana”, ka vërejtur një automjet i cili ishte duke lëvizur në drejtim të kundërt me shpejtësi të madhe dhe kishte kaluar në shiritin e kundërt qarkullues, e që është përplasur me automjetin para tij dhe posa është përplasur, në një moment e ka goditur edhe automjetin e të

dëmtuarit, në pjesën e përparme të anës së majtë ku si pasojë e goditjes së automjetit ka pasur dëme të konsiderueshme materiale, ndërsa i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar dhe i ka falur besimin deklaratës së ekspertit P.SH., pasi që ka mbështetje edhe në prova të tjera e sidomos në konstatimet e grupit të ekspertëve të fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, ku i njëjti ka theksuar se qëndron pranë ekspertizës së datës 30.07.2015, të dhënë nga ana e tij dhe gjatë seancës ka sqaruar se në momentin që kalon në shiritin e kundërt qarkullues automjeti i markës “Audi2, godet automjetin e markës Citroen C4 pas goditjes së këtij automjeti, godet automjetin e markës “Mercedes”250 në krahun e majtë në pjesën e përparme të automjetit. Në bazë të raporteve dhe skicës të vendit të ngjarjes nuk ka gjurmë të frenit dhe për shkak të oscilimeve (devijimeve) të rrugës që i janë bërë nga vozitësi i automjetit të markës “Audi”, i njëjti nuk ka pasur mundësi dhe nuk ka mundur me frenu për evitimin e aksidentit. Në atë pjesë të rrugës kanë qenë dy shirita qarkullues në drejtime të kundërta dhe gjerësia e rrugës në tersi për afërsisht ka qenë 6.90 m dhe pika goditëse ndërmjet automjeteve të markës “Audi” dhe të markës “Citroen”, ka qenë në drejtim të kundërt të automjetit të markës “Audi” dhe maksimumi i distancës së pikës goditëse duhet të ketë qenë 1m. Sipas deklaratës të ekspertit P.SH., rruga ka qenë pa ndriçim, e drejtë, pa gropa, e sinjalizuar me shenja vertikale dhe horizontale dhe nuk ka qenë rrugë e lagur në momentin kritik. Këtë gjendje faktike e ka përshkruar edhe në ekspertizën e tij të datës 30.07.2015. Nga super ekspertiza mbi aksidentin e komunikacionit datë 10.09.2010, e cila është nxjerrë, sipas propozimit të mbrojtësit të akuzuarit të akuzuarit dhe vet të akuzuarit, nga grupi i ekspertëve, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, është vërtetuar se deri të aksidenti ka ardhur si rezultat i lëshimit të drejtuesit të automjetit “Audi”, i cili nuk e ka mbajtur korsinë adekuate gjatë lëvizjes në rrugë por ka devijuar lëvizjen duke kaluar në korsinë e kundërt dhe fillimisht ndeshet me automjetin “Citroen” e më pastaj duke u ndeshur edhe me automjetin “Mercedes”. Nga ekspertiza mjeko ligjore e datës 21.11.2015, të lëshuar nga dr. N.U., është konstatuar se të dëmtuarit dhe vetë i akuzuari natën kritikë si pasojë e aksidentit kanë pësuar lëndime trupore. Kjo gjendje faktike e vërtetuar e gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar edhe nga provat e tjera materiale të lartcekura të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Gjykata e shkallës së parë edhe pse si provë ka lexuar ekspertizën e komunikacionit inxh. S.F., datë 17.01.2018, të njëjtën nuk e ka administruar si provë ngase kjo ekspertizë është e bazuar në prova thellësisht të pa mbështetshme, përkatësisht si provë bazë është marrë foto dokumentacioni i dorëzuar nga vet i akuzuari, origjina e të cilit është i panjohur dhe si e tillë për gjykatën është provë e pa pranueshme e mbi të gjitha nuk përket fare me foto dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës, të siguruar nga zyrtaret policorë në vendin e ngjarjes. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit dhe me të drejtë nuk ia fali besimin duke e vlerësuar si të paqëndrueshme dhe në kundërshtim me shkresat tjera të lëndës e të cilat e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i është vënë në barrë me anë të aktit akuzues. Një vlerësim të tillë si të drejtë dhe të ligjshme e aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket shkëljes së ligjit penal me ankesë mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se, në rastin konkret kemi përgjegjësi të ndarë sa i përket rrethanave të aksidentit, mirëpo organet e ndjekjes duke u bazuar në raportin e policisë, shkaktarin e aksidentit, drejtuesin e veturës “Mercedes” e kanë cilësuar si të dëmtuar, po ashtu, mbrojtësi i të akuzuarit konsideron se edhe me super ekspertizë është cekur fakti se foto zyrtare ose provat zyrtare janë të padukshme dhe nuk kanë mundur të vërtetojnë gjendjen faktike në bazë të provave të gjykatës së shkallës së parë, përveç se përfundimet e veta i kanë sjell përmes programit të tyre “Virtual Crash”, e jo në bazë të provave zyrtare të gjykatës së shkallës së parë.

Kjo gjykatë pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të akuzuarit për shkelje të ligjit penal i vlerëson si të pabazuara, pra kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarin e ka shpallë fajtor për veprën penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e cila i vihet në barrë me akuzë. Kolegji penal i kësaj gjykate, ka ardhur në përfundim se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, se vepra penale për të cilën ndiqet i akuzuari përbën vepër penale, se nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale, nuk ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, se është zbatuar ligji i aplikueshëm. Meqë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitat për matjen, zbutjen ose ashpërsimin e dënimit kundër të akuzuarit kur është shpallur fajtor për veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë përmend se aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e kundërshton edhe sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mirëpo nuk jep asnjë arsytim në lidhje me këtë bazë ankimore, prandaj kolegji penal i kësaj gjykate, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e shqyrtoj në këtë drejtim sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 396 të KPPK-së dhe gjeti se nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Kjo gjykatë vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysht dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të akuzuarin dhe atë konform dispozitës ligjore të nenit 73 të KPRK-së, me ç' rast gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarit nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana lehtësuese ka konsideruar sjelljen e tij korrekte gjatë gjykimin, është baba i katër fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes dhe faktin se më herët nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, ku çdo dënim tjetër nga ai i shqiptuar me këtë aktgjykim do të ndikonte negativisht në jetën e tij dhe të familjes si tërësi, e sidomos kujdesi financiar ndaj familjes.

Vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në prani të këtyre rrethanave nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi më të butë sikurse që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit. Gjukata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënim ndaj të akuzuarit, ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Duke pasur parasysht se në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit nuk është theksuar asnjë rrethanë e re lehtësuese që nuk ka qenë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë dhe që kishte për të ndikuar në shqiptimin e një dënimi më të butë, kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se dënimi i shqiptuar, nga gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës të kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit

nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT NË PRISHTINË
PA1.nr.170/19, datë 18.03.2019

Zyrtar ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:
Shqipe Qerimi
Afrim Shala